

URDHËR
Nr. 466, datë 11.11.2020

**PËR MIRATIMIN OSE REFUZIMIN E KËRKESAVE PËR ZHVILLIMIN E
PANAIREVE, EKSPOZITAVE, SHFAQJEVE TË CIRKUT LËVIZËS DHE
ZOOPTARQJEVE LËVIZËSE TË KAFSHËVE NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, në nenin 61, pika 3, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 390, datë 6.3.1993,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për miratimin ose refuzimin e kërkesave për zhvillimin e panairove, ekspozitave, shfaqjeve të cirkut lëvizës dhe zooparkjeve lëvizëse të kafshëve në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural, Agjencitë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

RREGULLORE

**PËR MIRATIMIN OSE REFUZIMIN E KËRKESAVE PËR ZHVILLIMIN E PANAIREVE,
EKSPOZITAVE, SHFAQJEVE TË CIRKUT LËVIZËS DHE ZOOPTARQJEVE LËVIZËSE TË
KAFSHËVE NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Neni 1

Qëllimi dhe objektivat

Qëllimi kryesor i këtij dokumenti është të përshkruajë standardet dhe udhëzimet që sigurojnë mirëqenien dhe sigurinë e kafshëve të përdorura për qëllime të ekspozitave dhe panairove. Kjo rregullore ka për qëllim, gjithashtu, zbatimin e masave të minimizimit të ekspozimit të mundshëm ndaj sëmundjeve infektive në kafshët gjatë panairove, ekspozitave dhe parandalimit e rrezikut të përhapjes së sëmundjeve infektive dhe zoonotike përmes organizimit të panairove dhe ekspozitave të kafshëve në mjedise të tjera publike.

Objektivi i kësaj rregullore është ruajtja e shëndetit publik dhe e shëndetit të kafshëve gjatë kohës së zhvillimit të panairove, ekspozitave dhe aktiviteteve të tjera me pjesëmarrje të kafshëve.

Neni 2

**Vendet dhe vendndodhja e ekspozitave, panairove dhe aktiviteteve të tjera me pjesëmarrje të
kafshëve**

1. Subjektet që merren me organizmin e ekspozitave, kopshteve zoologjike shëtitëse, transportin e kafshëve që udhëtojnë me trupat e cirkut, me organizimin e panaireve e të shitjeve të organizuara të kafshëve, jashtë mjediseve të stallave dhe stabilimenteve, njoftojnë paraprakisht me shkrim, autoritetin kompetent.

2. Autoriteti kompetent njofton me shkrim autoritetet e pushtetit vendor për kryerjen e ekspozitave, panaireve, kopshteve zoologjike lëvizëse, për vendin, kohën dhe llojin e kafshëve pjesëmarrëse në aktivitet.

3. Territoret ku zhvillohen panairët dhe ekspozitat e kafshëve janë pronë e bashkive.

4. Vendndodhja e tyre caktohet në bashkëpunim me shërbimin veterinar rajonal. Ato duhet të jenë larg qendrave të banuara dhe të sigurojnë kushtet normale për mirëqenien e kafshëve në panair apo ekspozitë. Ato duhet të sigurojnë lehtësi në largimin e plehut dhe të mbeturinave të tjera për në vendet e përpunimit të tyre gjatë kohës së zhvillimit të panaireve dhe të ekspozitave. Ato duhet të sigurojnë burime të mjaftueshme uji të pijshëm për kafshët pjesëmarrëse në këto aktivitete.

Neni 3

Statusi sanitar i kafshëve pjesëmarrëse në panair ose ekspozitë

1. Të gjitha kafshët që duhet të marrin pjesë në ekspozita, panair etj. duhet t'u nënshtrohen ekzaminimeve veterinare për të siguruar që të ekspozohen vetëm kafshë të shëndetshme.

2. Të gjitha testet, ekzaminimet fizike të kafshëve, të kryera për gjendjen e tyre shëndetësore, para pjesëmarrjes së kafshëve në këto aktivitete, duhet të jenë të dokumentuara dhe në përputhje me legjislacionin përkatës të shtetit ku kryhet aktiviteti.

3. Kafshët pjesëmarrëse në ekspozita, panair ose në shfaqje cirku, ose zooparqe lëvizëse, duhet të jenë të matrikulluara dhe të regjistruara në regjistrat përkatës kombëtarë.

4. Ato duhet të jenë të pajisura me certifikatë veterinare për të vërtetuar pastërtinë nga sëmundjet infektive ngjitëse.

5. Certifikata veterinare është e vlefshme vetëm për afatin kohor të kryerjes së aktivitetit.

6. Një kafshë e importuar për ekspozitë duhet të plotësojë kërkesat në fuqi për importin e specieve përkatëse dhe të shoqërohet me një kopje të certifikatës zyrtare shëndetësore ndërkombëtare ose një certifikatë zyrtare ndërkombëtare të inspektimit veterinar, të lëshuar nga një veterinar zyrtar i shtetit të origjinës.

7. Pronari i kafshëve pjesëmarrëse në ekspozita, panair, shfaqje cirku, zooparqe lëvizëse, të garantojë, nën përgjegjësinë e tij, që të gjitha raportet, testet, dokumentet e identifikimit zyrtar dhe certifikatat ndërkombëtare sanitare zyrtare ose certifikatat ndërkombëtare të inspektimit veterinar, që shoqërojnë kafshët, t'u paraqiten autoriteteve organizuese të aktivitetit, sa herë që kërkohet prej tyre.

Neni 4

Transporti i kafshëve për dhe nga vendet e kryerjes së panaireve, ekspozitave

Transporti i kafshëve duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

1. Në mjetin e transportit kafshët nuk duhet të përzihen me specie të ndryshme dhe kafshë të panjohura.

2. Mjetet e transportit duhet të jenë të përshtatshme në lidhje me speciet e kafshëve të transportuara. Ata duhet të jenë mjaftueshëm të mëdha për të lejuar që kafsha të lëvizë në mënyrë të përshtatshme.

3. Çdo kafshë e marrë ose e dërguar duhet të transportohet sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin aktual.

4. Mbajtësi i licencës së transportit duhet të tregojë që automjeti në dispozicion është i përshtatshëm për të transportuar kafshët.

5. Personat përgjegjës për transportin e kafshëve duhet të kenë një protokoll të shkruar të masave që duhet të merren gjatë prishjes së automjetit të transportit ose çdo lloj tjetër emergjence. Në rast të kundërt nuk duhet të jepet leja e transportit.

6. Të gjitha kafshët, ndërsa janë në tranzit, duhet të udhëtojnë në temperaturë të përshtatshme për speciet e tyre. Ato duhet të kenë akses pa pengesa në ujëpirje dhe ushqim.

7. Mjetet e transportit duhet të mirëmbahen në një gjendje të pastër dhe higjienike.

8. Çdo kafshë duhet të kontrollohet për shenja të dëmtimit, sëmundjes, shqetësimit ose frikës menjëherë para dhe pas transportit dhe duhet të marrë trajtim të shpejtë nëse nevojitet.

Neni 5

Masat që duhet të ndërmerren gjatë panairëve, ekspozitave etj., për parandalimin e hyrjes dhe të përhapjes së agjentëve infektivë ngjitës dhe zoonotikë

1. Gjatë këtyre eventeve kafshët duhet të mbahen në mjedise të rehatshme për të ndihmuar në uljen e stresit.

2. Duhet të kenë në dispozicion sasi të mjaftueshme të ujit të pijshëm dhe të ushqimit.

3. Duhet të shmanget kontakti-kafshë dhe kontaktet me kafshë nga ferma të tjera.

4. Të pastrohen dhe të dezinfektohen gjatë gjithë periudhës kohore të eventit mjetet e ujit dhe të ushqimit.

5. Për kafshët e qumështit, bokset e mbajtjes së tyre duhet të pajisen detyrimisht me makinë portative mjeljeje. Ndalohet në mënyrë kategorike huazimi nga persona të fermave të tjera.

6. Ndalohet kontakti i vizitorëve me kafshët.

7. Ndalohet hedhja e ushqimit nga vizitorët në kafshët e panairit, ekspozitave, shfaqjeve të cirkut dhe kopshteve zoologjike të lëvizshme.

8. Duhet të shmanget ndarja e pajisjeve me ekspozuesit e tjerë.

9. Shërbimi veterinar duhet të monitorojë të gjitha masat e marra për parandalimin e futjes dhe përhapjes së sëmundjeve ngjitëse dhe zoonotike gjatë zhvillimit të eventit.

Neni 6

Masat që duhet të ndërmerren pas përfundimit të panairëve, ekspozitave etj., për parandalimin e hyrjes dhe të përhapjes së agjentëve infektivë ngjitës dhe zoonotikë

1. Pas kthimit nga këto aktivitete, kafshët në vëndorigjinë duhet të mbahen të ndara nga pjesa tjetër e tufës për 3–4 javë.

2. Të monitorohen kafshët në izolim për shenja të sëmundjes, të tilla si: ethe, diarje, anomalitë e lëkurës, vezikula, mastite ose aborte. Të kontaktohet shërbimi veterinar në rast të shfaqjes së shenjave klinike për sëmundje.

3. Duhet detyrimisht të pastrohen dhe të dezinfektohen enët e ujit ose të ushqimit, të cilat janë përdorur në aktivitet, përpara se të përdoren për pjesën tjetër të tufës.

4. Veterineri zyrtar duhet të kontrollojë zbatimin e të gjitha masave të marra pas kthimit nga aktiviteti.

Neni 7

Detyrat e veterinerit zyrtar në panairë ekspozita etj.

1. Miraton pastrimin dhe dezinfektimin e ambienteve të panairit, ekspozitës etj., para dhe gjatë panairit, ekspozitës etj.
2. Inspekton të gjitha kafshët në ditën e pranuar në aktivitet dhe të paktën një herë në ditë gjatë aktivitetit.
3. Refuzon pranimin në aktivitet të kafshëve që manifestojnë shenja klinike të ndonjë sëmundjeje infektive, ngjitëse ose të kafshëve që nuk përmbushin kërkesat e hyrjes në event.
4. Të mbajë të dhënat për identifikimin zyrtar aplikuar gjatë ekspozitës, duke përfshirë: numrin, specien, gjininë, moshën dhe llojin e kafshëve.
5. Të mbajë datën e aplikacionit, emrin dhe adresën e ambienteve ku është identifikuar kafsha.

Neni 8

Detyrat e menaxherit të eventit

1. Kontrollon të gjitha detyrat e lëna nga veterineri zyrtar.
2. Përmbush të gjitha urdhrat e veterinerit zyrtar që kanë të bëjnë me kanalizimet e ambienteve dhe gjendjen shëndetësore të të gjitha kafshëve pjesëmarrëse në aktivitet.
3. Pastron dhe dezinfekton të gjitha mjediset ku kryhet aktiviteti për përdorimin e bagëtive, para datës së hapjes së aktivitetit dhe gjatë eventit, nëse arrijnë kafshë të reja.
4. Mban kafshët dhe zonat e eventit në kushte sanitare.
5. Siguron që çdo kafshë që tregon simptoma të sëmundjeve infektive, ngjitëse, të hiqet nga mjediset ku zhvillohet aktiviteti ose të karantimohet në një strukturë të veçantë.
6. Mban shënime, të cilat përfshijnë emrin dhe adresën e secilit ekspozues së bashku me speciet, klasën dhe numrin e kafshëve të ekspozuara.